



Basic Facts



Misioni

EULEX Kosova ka filluar në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrotjtje. Misioni i përgjithshëm i EULEX-it është t'i asistojë autoriteteve të Kosovës në ngritjen e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit.

Mandati aktual i Misionit ka filluar për të mbuluar periudhën deri më 14 qershor 2020 në bazë të Vendimit të Këshillit CFSP 2018/856. EULEX-i funksionon brenda kornizës së Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244.

Misioni EULEX i mbështetë institucionet relevante të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në përputhje të plotë me praktikën më të mira të BE-së. Në kuadër të mandatit aktual, Misioni zhvillon aktivitete të monitorimit dhe ka funksione ekzekutive të kufizuara. Misioni vazhdon t'i mbështetë Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.



EULEX KOSOVO
Partnership for Justice

Mandati

EULEX Kosova zbaton mandatin përmes Shtyllës për Monitorim dhe Shtyllës për Operacione. Shtylla për Monitorim bënë monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të caktuara në sistemin e drejtësisë të Kosovës. Ajo i përqendron aktivitetet e veta të monitorimit në raste të përzgjedhura të cilat janë trajtuar nga EULEX-i gjatë mandatit të tij të mëparshëm që ka përfunduar në mes të qershorit 2018 dhe që më pastaj i janë dorëzuar gjyqësorit vendas, si dhe në raste të tjera që mund të kenë ndikim mbi rrugëtimin evropian të Kosovës.

Shtylla për Monitorim po ashtu e mbështetë Shërbimin Korrektues të Kosovës për të zhvilluar ekip menaxherial të lartë të konsoliduar dhe profesionist si dhe kapacitete të qëndrueshme për të luftuar ndërhyrjet e papranueshme dhe trajtimet preferenciale të të burgosurve.

EULEX-i vazhdon të ofrojë mbështetje teknike për zbatimin e marrëveshjeve përkatëse nga Dialogu i fasilituar nga BE-ja për normalizimin e raporteve mes Beogradit dhe Prishtinës.

Funksionet operacionale kryhen nga Shtylla Operative e Misionit e cila ka kapacitet të mbetur të kufizuar si reagues i dytë në fushën e sigurisë dhe ofron mbështetje të vazhduar për kapacitetet e Policisë së Kosovës për kontrollin e turmave dhe të trazirave. Misioni vazhdon ta menaxhojë programin e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe i ndihmon Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar me mbështetje logjistike dhe operacionale në pajtim me legjislacionin përkatës të Kosovës.

Fakte të shpejta:

Mandati: deri më 14 qershor 2020

Ushtrues i detyrës së Shefit të Misionit: z.Cezary Luba

Kapaciteti i autorizuar: 503 staf

Zyrat qendrore: Prishtinë, Kosovë

Baza ligjore: Veprimi i Përbashkët i BE-së i muajit shkurt 2008 dhe Vendimet pasuese të Këshillit të qershorit 2010, 2012, 2014, 2016, 2018.

EULEX-i mbështetet nga të gjitha 28 Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga pesë shtete kontribuuese (Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara).



Press contacts and general information:
press@eulex-kosovo.eu and info@eulex-kosovo.eu
www.eulex-kosovo.eu

 www.twitter.com/eulexkosovo
 www.facebook.com/eulex.kosovo
 www.youtube.com/eulexkosovo